



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 602/1 Prot.

Tiranë, më 30.05. 2023

V E N D I M

Nr.77 , Datë 30.05. 2023

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 77 Regj, datë 16.05.2023, të paraqitur nga znj. E.D kundër Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë Korçë (KMCAP Korçë), në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes shëndetësore”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas pretendimeve dhe shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, ankuesja shprehet se:

“Quhem E.D. Jam banore e qytetit të Korçës. Po ju drejtohem për një problem të cilin e shikoj si diskriminim dhe shkelje të të drejtave të njeriut nga KMCAP Korçë për shkak të gjendjes time shëndetësore.

Pas 20 vitesh vuaj nga sëmundja e hepatitit C, por këto vitet e fundit kjo sëmundje ka agravuar dhe është kthyer në CIRROZEHEPATIKE VIRALE C. Jam shtruar shpesh herë në spital në Tiranë dhe Korçë ku jam trajtuar me kura të ndryshme. Në vitin 2021 jam trajtuar me KEMP me këtë diagnozë. Në 2022 kam përsëritur dokumentat, por më është refuzuar marrja e KEMP-it, me arsyen se sëmundja ime nuk hynte më në rimbursim, pasi ishte hequr nga shteti. Këtë përgjigje më dha doktoresha që është pranë komisionit mjekësor në Korçë znj. V.

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

Situata ime shëndetësore është e rënduar dhe për këtë arsye kam shkuar dhe jam trajtuar në spital pranë QSUT, ku mjeku përkatës më ka dhënë përsëri fletëdalje për në KEMP dhe më thotë që t'i duhet të trajtohesh sepse gjendja jote është e rënduar, dhe ilaçi që përdor është tepër i shtrenjtë (nuk hyn në rimbursim). Mundësitë e mia financiare dhe gjendja ekonomike nuk më lejon që unë të marr këtë medikament pasi jam vetëm me ndihmë ekonomike. Në muajin shkurt 2023, mjeku specialist në Korçë dhe ai në Tiranë, përsëri më kanë dhënë fletën e drejtimit për KEMP, por doktoresha e komisionit përsëri më ka refuzuar”.

Ankuesja kërkon nga Komisioneri zgjidhjen e rastit të saj dhe nëse kjo sëmundje është hequr nga rimbursimi, të rifutet përsëri në listë për marrjen e ndihmës sociale për personat me aftësi të kufizuar, pasi ka shumë persona të tjerë që janë penalizuar në të njëjtën mënyrë me ankuesen.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të LMD, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga LMD, në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Në bazë të nenit 7, të LMD, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Nga shqyrtimi paraprak i parashtrimeve dhe dokumentacionit të depozituar nga ankuesja pranë Komisionerit, konstatohet se:

Me vendimin nr.3549, datë 9.9.2022, Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë, KMCAP Niveli i Parë Sëmundjet e Brendshme, pranë Shërbimit Social Shtetëror, për vlerësimin e personave me aftësi të kufizuara në rrethin e Tiranës, ka vendosur: *“Të caktojë E.D, se nuk caktohet Person me aftësi të kufizuar, grupi pa grup, prej datës 1.10.2022...”.* Referuar vendimit diagnoza për ankuesen është “Hepatit C dhe B kronik”. Në pjesën “Shënime” të vendimit është

pasqyruar: “Nuk ka sjellë ekzaminimet e kërkuara”. Referuar shpjegimeve dhe dokumentacionit të depozituar nga ankuesja, nuk rezulton që ajo të ketë kundërshtuar vendimin në KMCAE epror.

Nga aktet e depozituara nga ankuesja rezulton se, Komisioni Mjekësor, Pavioni i Sëmundjeve të Brendshme, Shërbimi Gastrohepatologji, pranë Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë, ka lëshuar për ankuesen “Fletë Drejtimi për Komisionin Mjekësor për Ndhmë Ekonomike” me nr. Kartele A250377, datë 27.12.2022, me diagnozën “Hepatit Kronik C, me ngarkesë të lartë virale”. Pas kryerjes së ekzaminimeve dhe mbi bazën e rekomandimeve të mjekut specialist gastrohepatolog pranë Poliklinikës së Specialiteteve Korçë, rezulton se, në datën 23.2.2023 për ankuesen, është plotësuar nga mjeku specialist gastrohepatolog, formulari i aplikimit për vlerësimin mjekësor për caktimin e aftësisë së kufizuar, për të rritur, sipas modelit bio psiko social. Referuar shpjegimeve dhe dokumentacionit të depozituar prej ankuseses, nuk rezulton që ankuesja të ketë dalë për vlerësim para komisionit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar. Pra, nuk ka një vendimarrje, nëse ankuesja është vlerësuar ose jo si person me aftësi të kufizuar, në lidhje me aplikimin e sipërcituar.

Pasi shqyrtoi pretendimet dhe dokumentacionin e depozituar nga ankuesja, Komisioneri vlerëson se, rimarrja në shqyrtim e vendimeve të organeve të specializuara mjeko-ligjore siç janë komisionet e vlerësimit të aftësisë së kufizuar, nuk bën pjesë në kompetencat e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Në nenin 8 të Ligjit nr. 57, datë 18.07.2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet se: “Përfitues të pagesës për aftësinë e kufizuar janë: a) personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të cilët deklarohen me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë se janë bërë të tillë, pavarësisht nga shkak dhe mosha; b) personat me aftësi të kufizuar, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, si dhe personat e paaftë për punë, sipas Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, të cilët nuk plotësojnë kushtet ligjore për përfitim të pensionit të invaliditetit të punës sipas ligjit të sigurimeve shoqërore në Republikën e Shqipërisë; c) personat me aftësi të kufizuar, të deklaruar të tillë me vendim të Komisionit Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar; ç) personat, të cilët janë deklaruar invalidë pune me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, që përfitojnë pension invaliditeti dhe shtesë mujore mbi të, sipas Statusit të Invalidit të Punës”.

Neni 29 i këtij Ligji, shprehet në mënyrë të detajuar për procedurën e ankimit, në rastet kur aplikuesit/përfituesit nuk janë dakord me vendimarrjet e komisioneve të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, duke përcaktuar se: “1. Aplikuesi për përfitim të ndihmës ekonomike, kur gjykon se vendimi zyrtar i organit përkatës është i padrejtë dhe personi me aftësi të kufizuar, kur gjykon se i është shkëtur një e drejtë e garantuar nga ky ligj, mund të paraqesin ankesë me shkrim pranë bashkisë/njësisë administrative brenda 20 ditëve kalendarike nga marrja e njoftimit. Struktura vendore shqyrton ankesën dhe njofton me shkrim ankuesin brenda 7 ditëve kalendarike nga marrja e ankesës. 2. Aplikuesi për përfitim të ndihmës ekonomike dhe personi me aftësi të

kufizuar kanë të drejtë të paraqesin ankesë me shkrim pranë strukturës rajonale të Shërbimit Social Shtetëror brenda 20 ditëve kalendarike nga marrja e përgjigjes nga struktura vendore, pas ezaurimit të ankimit, të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni. 3. Struktura rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, pas shqyrtimit dhe verifikimit të ankesave, njofton me shkrim të interesuarin dhe njësinë e vetëqeverisjes vendore brenda 14 ditëve kalendarike nga marrja e ankesës. 4. Aplikuesi për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe personi me aftësi të kufizuar, që pretendojnë se u është shkelur dhe/ose mohuar një e drejtë ligjore, gëzojnë të drejtën për të ngritur padi në gjykatë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Aktualisht vlerësimi i aftësisë së kufizuar bëhet në kuadër të sistemit të mbrojtjes sociale dhe atij të sigurimeve shoqërore. Në kuadër të sistemit të mbrojtjes sociale, vlerësimi i aftësisë së kufizuar, sikurse është rasti i paraqitur nga ankuesja, rregullohet nga Vendimi nr. 182, datë 26.2.2020 “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të ndihmës personal” dhe Vendimi nr. 722, datë 11.11.2019, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësisë së kufizuara, si dhe të ndihmës personal, dhe të strukturave përgjegjëse”, nga të cilët, ky i fundit rregullon vlerësimin e aftësisë së kufizuar sipas modelit bio psiko social.

Rezulton se vendimi nr. 3549, datë 9.9.2022, që nuk e ka vlerësuar ankuesen si person me aftësi të kufizuar, është marrë nga KMCAP dhe jo nga Komisionit Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar. Në këtë kontekst, akti nënligjor që gjen zbatim është VKM nr. 182, datë 26.02.2020.

Në kreun V, të vendimit nr. 182, datë 26.02.2020, është parashikuar e drejta e ankimit të aplikuesit, lidhur me procedurën e vlerësimit, në rastet e refuzimit të aplikimit për përfitimet lidhur me përfitimet për shkak të aftësisë së kufizuar, duke përcaktuar se: “1. Kundër vendimit të KMCAP-së së nivelit të parë personi mund të bëjë ankim brenda 30 (tridhjetë) ditëve në komisionin epror. Procedura e ankimit kryhet, si më poshtë vijon: a) Ankimi në komisionin epror bëhet me shkrim dhe dorëzohet pranë drejtorive rajonale të shërbimit social shtetëror; b) Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës, drejtoria rajonale e shërbimit social shtetëror dërgon në Shërbimin Social Shtetëror dosjen e ankimuesit, së bashku me një relacion të hollësishëm, ku argumentohet vendimi i marrë nga KMCAP-ja e nivelit të parë; c) Shërbimi Social Shtetëror njofton anëtarët e KMCAP-së eprorë dhe ankimuesit 7 (shtatë) ditë përpara zhvillimit të seancës së komisionit epror. 2. Mjeku pranë Shërbimit Social Shtetëror, në rolin e relatorit, studion dokumentacionin e dosjes, procedurat e zbatuara në KMCAP-në e nivelit të parë, dokumentacionin e vlerësuar nga ky komision, pretendimet e parashtruara nga ankimuesi dhe përgatit një relacion, ku, ndër të tjera, shprehet edhe për referencën e gjendjes shëndetësore të ankimuesit, sipas kriterëve mjekësore orientuese për përcaktimin e aftësisë së kufizuar. 3. Seancat e mbledhjes së komisionit janë të përmuajshme dhe zhvillohen brenda një muaji, nga data e paraqitjes së dokumenteve në Shërbimin Social Shtetëror. Seanca zhvillohet në ditët e

caktuara nga komisioni epror, i cili tërhiqet për të marrë vendimin pa praninë e personit. Komisioni epror mbledhet jo më pak se dy herë në muaj dhe kur janë mbledhur jo më pak se 20 dosje. 4. Vendimet e komisionit epror merren me shumicë të thjeshtë votash. Mbledhja mund të zhvillohet edhe në mungesë të njërit prej anëtarëve, por asnjëherë në mungesë të kryetarit. Në rastet kur ka barazi votash, në fund vendos vota e kryetarit të komisionit. 5. Anëtarët e komisionit epror kanë të drejtë të argumentojnë votën e tyre pro ose kundër. Vendimi i komisionit epror plotësohet sipas formatit nr. 3, bashkëlidhur këtij vendimi. 6. Vendimi i komisionit epror arkivohet në dosjen përkatëse dhe i njoftohet me shkrim edhe ankimuesit, brenda një afati 8-ditor. 7. Nëse ankimuesit nuk paraqiten para komisionit 2 herë radhazi dhe refuzojnë të kryejnë ekzaminimet e kërkuara apo mjekimin e rekomanduar, komisioni epror merr vendim “pa aftësi të kufizuar”, dhe dosja i kthehet drejtorisë rajonale të shërbimit social shtetëror. Në këtë rast, dosja konsiderohet e mbyllur dhe për rihapjen e saj do të ndiqet procedura si për rastet që paraqiten para komisionit për herë të parë. 8. Komisioni epror nuk mund të marrë në rishqyrtim rastet për të cilat ai është shprehur një herë, në rastet kur ankimuesi ka të njëjtën gjendje shëndetësore, për të cilën pretendohet aftësi e kufizuar.”

Bazuar në sa më sipër, pas marrjes së vendimit të KMCAP së nivelit të parë, nëse personi nuk është dakord me këtë vendim, mund ta apelojë atë në KMCAP Epror të specializuar. Kërkesa bëhet me shkrim nga individit dhe dorëzohet pranë drejtorive rajonale të SHSSH. Këto drejtori duhet të dërgojnë kërkesën pranë SHSSH brenda 10 ditëve. Bashkë me këtë kërkesë, që është ankim nga ana e individit, mjekët e ekspertizës përgatisin dhe një relacion të hollësishëm që argumenton vendimin që kanë marrë.

Në rastet e ankimimit të vendimit të KMCAP, Niveli i Parë, për nivelin e përfitimit të aftësisë së kufizuar, Komisioni i nivelit më të lartë në SHSSH, KMCAP Epror, vlerëson nëse ankimi është i pranueshëm dhe i bazuar, dhe vendos përfundimisht me anë të një vendimi. Përgjigjja e argumentuar, pra vendimi i arsyetuar që marrin këto komisione, lidhet kryesisht me vlerësimin dhe caktimin e diagnozës mjekësore. Për shkak të natyrës specifike apo natyrës juridike të marrëdhënies që krijohet gjatë vlerësimit të aftësive për punë, këto vendime mund të merren vetëm nga mjekët e specializuar pranë KMCAP-ve të nivelit të parë dhe Epror. Komisioni i Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar është një ekip i përzgjedhur, i përbërë nga mjekë të specializuar.

Sa më sipër ankuesja duhet ta kishte kundërshtuar vendimin e marrë nga KMCAP Niveli i Parë pranë KMCA Epror, por nuk rezulton që ta ketë bërë një gjë të tillë.

Nga aktet e administruara rezulton se aplikimi që ankuesja ka bërë në datën 23.2.2023 është bërë sipas formularëve për vlerësimin e aftësisë së kufizuar, bazuar në modelin bio psiko social. Në këtë kontekst, akti nënligjor që gjen zbatim është VKM nr.722, datë 11.11.2019.

Në kreun V, të vendimit nr. 722, datë 11.11.2019, është parashikuar e drejta e ankimimit të aplikuesit, lidhur me procedurën e vlerësimit, në rastet e refuzimit të aplikimit për përfitimet

lidhur me përfitimet për shkak të aftësisë së kufizuar, duke përcaktuar se: “1. Aplikuesi ka të drejtën e ankimimit për procedurën e vlerësimit në rastet e refuzimit të aplikimit për përfitime për shkak të aftësisë së kufizuar. Ankimimi bëhet me shkrim, brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike, nga data e marrjes së njoftimit të vendimit nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, pranë komisionit të shqyrtimit të ankesave në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, e cila shqyrton dokumentacionin e ankimesit, kryen intervistën sipas formularit 6, bashkëlidhur këtij vendimi dhe merr vendimin përfundimtar. Në rastet kur kërkesa pranohet, personit i lind e drejta e marrjes së përfitimeve që nga muaji pasardhës, nga data e marrjes së vendimit për refuzim nga komisioni. 2. Personi me aftësi të kufizuar, që pretendon se i është shkelur dhe/ose mohuar një e drejtë, gëzon të drejtën për të ngritur padi në gjykatë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, pasi ka ezauruar shkallët e ankimimit administrativ. Personit i lind e drejta e marrjes së përfitimeve, sipas afateve të përcaktuara në vendimin e gjykatës”.

Bazuar në sa më sipër, pas marrjes së njoftimit të refuzimit të aplikimit për përfitimet për shkak të aftësisë së kufizuar, nëse personi nuk është dakord, mund ta apelojë atë pranë komisionit të shqyrtimit të ankesave në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, Aplikuesi ka të drejtën e ankimimit për procedurën e vlerësimit edhe në rastet kur ai pretendon për nivelin e përfitimit të pagesës mujore për shkak të aftësisë së kufizuar. Në rastet e ankimimit të vendimit të komisioneve shumëdisiplinore të nivelit të parë, për nivelin e përfitimit të aftësisë së kufizuar, Komisioni i nivelit më të lartë në SHSSH, Komisioni Shumëdisiplinor Epror, vlerëson nëse ankimi është i pranueshëm dhe i bazuar, dhe vendos përfundimisht me anë të një vendimi i cili në vetvete përbën një akt administrativ. Përgjigjja e argumentuar, pra vendimi i arsyetuar që marrin këto komisione, lidhet kryesisht me vlerësimin dhe caktimin e diagnozës mjekësore.

Me vlerësimin e ri bio-psiko-social, personat me aftësi të kufizuar mbështeten financiarisht sipas shkallës së sëmundjes dhe kompleksitetit të saj, gjë e cila përcaktohet nga komisionet e dedikuara, multidisiplinore, të cilat kanë në përbërje figura profesionale mjekë dhe punonjës socialë. Për shkak të natyrës specifike apo natyrës juridike të marrëdhënies që krijohet gjatë vlerësimit të aftësive për punë, këto vendime mund të merren vetëm nga mjekët e specializuar pranë Komisioneve shumëdisiplinore Rajonale dhe Eprorë. Komisioni i Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar është një ekip i përzgjedhur, i përbërë nga së paku një mjek i specializuar dhe të paktën një psikolog, të cilët janë përgjegjës për kryerjen e vlerësimit të aplikuesve për përfitimet në para dhe/ose në natyrë për shkak të aftësisë së kufizuar, bazuar kryesisht në dokumentet e përgatitura nga institucionet shëndetësore.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri çmon se, vlerësimi nëse ankuesja, duhet apo jo të rezultojë fituese e përfitimeve të caktuara për shkak të aftësisë së kufizuar, mund bëhet vetëm nga Komisioni Shumëdisiplinor i Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar.

Në përfundim, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i rekomandon ankueses që, bazuar në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në ligjin 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, dhe në ligjin nr. 57, datë 18.07.2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, nëse nuk do të jetë dakord me procedurën e vlerësimit të aplikimi që ka bërë në datë 23.02.2023, për përfitime për shkak të aftësisë së kufizuar, ajo ka të drejtën e ankimimit, me shkrim, brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike, nga data e marrjes së njoftimit të njoftimit/vendimit nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, pranë komisionit të shqyrtimit të ankesave në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror. Pra, fillimisht ankuesja duhet të ezaurojë ankimimin administrativ, pranë komisionit të shqyrtimit të ankesave në DPSHSSH, dhe nëse nuk do jetë dakord as me përgjigjen apo vendimmarrjen e këtij të fundit, i cili është i formës së prerë, por jo përfundimtar, mund t’i drejtohet Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për t’a kundërshtuar gjyqësisht atë.

Për sa më sipër, referuar nenit 33/4/b, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se: “Ankesa nuk pranohet nëse: b) është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji;”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b, të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së paraqitur nga ankuesja E.D, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Gjendja shëndetësore
Fusha: Shërbime
Lloji i vendimit: Mospranim